



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.999/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ferki Xhaferi kryesues, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatës për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Lipjanit Lumturije Bytyqi Hasani nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Lipjan paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.999/2021 i datës 04.11.2021, paraqitur nga kandidatja për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Lipjanit Lumturije Bytyqi Hasani nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Lipjan, me të cilën ka kërkuar rinumërimin e votave në qendrat e votimit në Lipjan

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Lipjanit Lumturije Bytyqi Hasani nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Lipjan, në të cilën kërkon rinumërimin e votave në qendrat e votimit në Lipjan pasi që është e sigurt se votuesit e kanë votuar mirëpo votat nuk i figurojnë në rezultatet përfundimtare të shpallura nga KQZ-ja.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton se kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Lipjanit Lumturije Bytyqi Hasani nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Lipjan, ka parashtruar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në qendrat e votimit në Lipjan.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin

konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.999/2021 më datën 06.11.2021

Kryesues i Panelit
Ferki Xhaferi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimet të këtij vendimi.